



Në mbështetje të nenit 64, paragrafit 2 dhe nën paragrafëve 2.1 dhe 2.2 dhe neneve 8, 11, 96, 97 dhe 98 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe neneve 20, 24 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 23.07.2024, miraton këtë:

## **RREGULLORE NR. 17/2024**

### **REGJISTRIMI DHE VOTIMI JASHTË KOSOVËS**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit për të votuar nga jashtë Kosovës, pranimin dhe evidentimin e dërgesave postare, procedimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të pranura përmes postës dhe platformës elektronike, procesin e konfirmimit dhe kundërshtimit, votimin përmes postës, vlerësimin e dërgesave postare të pranura përmes postës dhe votimin në përfaqësi diplomatike.

#### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga KQZ dhe vlen për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët regjistrohen dhe votojnë jashtë Kosovës.

#### **Neni 3**

#### **Regjistrimi për të votuar jashtë Kosovës**

1. Shtetasi, i cili jeton jashtë Kosovës, mund të votojë për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë Rregullore, nëse aplikon dhe regjistrohet suksesshëm për votim jashtë Kosovës, në periudhën kohore të përcaktuar përmes kësaj Rregullore.
2. Shtetasi me të drejtë vote, i cili jeton jashtë Kosovës, mund të aplikojë si votues jashtë Kosovës, duke dërguar kërkesën për regjistrim sipas njërës nga mënyrat në vijim:
  - 2.1. Përmes platformës elektronike të aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës;
  - 2.2. përmes postës, në kutinë postare të KQZ.
3. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet duke plotësuar dhe bashkangjitur:

- 3.1. Të dhënat në formularin elektronik për regjistrim (duke përfshirë email adresën);
  - 3.2. kopjen e njërit prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi;
  - 3.3. verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit;
    - 3.3.1. aplikuesi ngarkon fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës;
    - 3.3.2. nëse aplikimi bëhet përmes platformës elektronike shtetërore E-Kosova, aplikuesi duhet të ketë kaluar verifikimin e dyfishtë të identitetit.
  - 3.4. Në rast se dokumenti identifikues i lëshuar nga Republika e Kosovës është me afat të skaduar, duhet bashkëngjitur edhe një kopje e dokumentit të vlefshëm të identitetit të shtetit në të cilin jeton.
4. Kërkesa për regjistrim përmes postës bëhet duke plotësuar dhe bashkëngjitur:
- 4.1. Formularin e regjistrimit, të plotësuar dhe të nënshkruar (Shtojca I – Formulari i aplikimit për regjistrim);
  - 4.2. kopjen e njërit nga dokumentet e identitetit, të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi;
  - 4.3. në rast se dokumenti identifikues i lëshuar nga Republika e Kosovës është me afat të skaduar, duhet bashkëngjitur edhe një kopje e dokumentit të vlefshëm të identitetit të shtetit në të cilin jeton.
    - 4.3.1. aplikuesi ngarkon fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë, të hapur, dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës.
5. Shtetasi gjatë aplikimit për regjistrim zgjedh njëri nga mënyrat e votimit:
- 5.1. Të votojë fizikisht, në njërin prej përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës. Kjo alternativë vlen vetëm për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
  - 5.2. duke dërguar fletëvotimin përmes postës në kutinë postare të KQZ në Kosovë;
  - 5.3. duke dërguar fletëvotimin përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ jashtë Kosovës.
6. Në rrethana të jashtëzakonshme, atëherë kur për shkaqe objektive është i pamundur regjistrimi përmes platformës elektronike të KQZ nga paragrafi 2.1, KQZ mundëson regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës edhe përmes email-it personal.
7. Në bazë të vlerësimit të kapaciteteve për votim në përfaqësi diplomatike, KQZ përcakton numrin maksimal të votuesve për secilën përfaqësi diplomatike, të caktuar si qendër votimi.
8. Në rast të plotësimit të numrit maksimal të votuesve në përfaqësi diplomatike, sipas parimit të kohës së aplikimit, aplikuesi do të udhëzohet për mënyrat e tjera të votimit.

9. Periudha e regjistrimit për votim jashtë Kosovës fillon menjëherë pas publikimit të Listës Preliminare të Votuesve dhe përfundon jo më vonë se 45 ditë para ditës së zgjedhjeve.
10. KQZ, në baza ditore shqyrton kërkesat për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, me qëllim të verifikimit të aplikacioneve dhe dokumenteve. KQZ, menjëherë pas shqyrtimit të kërkesës, njofton përmes emailit secilin aplikues jashtë Kosovës për statusin e aplikimit.

#### **Neni 4**

##### **Pranimi dhe evidentimi i kërkesave për regjistrim përmes postës**

1. Kërkesa për regjistrim përmes postës pranohet nga zyrtari i Shërbimit Votues dhe mbahet evidencë për numrin e zarfeve, që pranohen sipas datave, siç përcaktohet me Shtojcën II – Formulari i evidentimit të dërgesave përmes postës në kutinë postare të KQZ.
2. Zarfi që përmban formularin e regjistrimit duhet ta ketë datën e dorëzimit dhe pullën/vulën postare të shtetit nga ku është dërguar.

#### **Neni 5**

##### **Procedimi i aplikacioneve të pranuar përmes postës**

1. Formularët e regjistrimit me dokumentet mbështetëse, të pranuar përmes postës në kutinë postare në Kosovë, futen në platformën elektronike nga Shërbimi Votues.
2. Shërbimi Votues vlerëson dhe miraton aplikacionet e kompletuara sipas kriterëve të caktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.
3. Shtetasit që regjistrohen suksesshëm do të pranojnë përmes email-it dëftesën e regjistrimit, e cila përmban kodin unik të regjistrimit, të gjeneruar në barkod, dhe i cili do të shërbejë për identifikimin e votuesit në periudhën e votimit përmes postës.
4. Të gjitha aplikimet e pakompletuara, të cilat kanë mungesë të dokumenteve mbështetëse, refuzohen. Në këto raste KQZ udhëzon aplikuesit për riaplikim, duke bërë plotësimin e dokumenteve brenda periudhës së regjistrimit, apo për të ushtruar të drejtën e kundërshtimit administrativ.

#### **Neni 6**

##### **Vlerësimi i aplikacioneve të pranuar përmes platformës elektronike**

1. Shërbimi Votues analizon dhe vlerëson aplikacionet e pranuar përmes platformës elektronike, sipas kriterëve të caktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.
2. Shtetasit që regjistrohen suksesshëm, do të pranojnë përmes email-adresës dëftesën e regjistrimit, e cila përmban kodin unik të regjistrimit, të gjeneruar në barkod, që do të shërbejë për identifikimin e votuesit në periudhën e votimit përmes postës.

3. Të gjitha aplikimet e pakompletuara, të cilat kanë mungesë të dokumenteve mbështetëse, refuzohen. Në këto raste KQZ udhëzon apikuesit për riaplikim, duke bërë plotësimin e dokumenteve brenda periudhës së regjistrimit, apo për të ushtruar të drejtën e kundërshtimit administrativ.

#### **Neni 7**

##### **Procesi i konfirmimit dhe kundërshtimit të listës së votuesve jashtë Kosovës**

1. Personi që jeton jashtë Kosovës, i cili ka aplikuar për regjistrim dhe të cilit i është refuzuar kërkesa për të votuar jashtë Kosovës, gëzon të drejtën e kundërshtimit administrativ në KQZ deri në njëzet e katër (24) orë pas përfundimit të afatit të regjistrimit.
2. Ankesa parashtrohet përmes email-it në adresën elektronike zyrtare të KQZ, të krijuar për këtë qëllim.
3. KQZ themelon një komision brenda institucionit, i cili shqyrton kundërshtimin administrativ.
4. Nga momenti i pranimit të kundërshtimit, komisioni obligohet që brenda 24 (njëzet e katër) orëve ta shqyrtojë kërkesën. Në rast të miratimit, komisioni njofton menjëherë palën e ankuar, ndërsa në rastet e refuzimit, komisioni ia paraqet KQZ rekomandimin për refuzim.
5. Personi, të cilit i është refuzuar kundërshtimi administrativ, ka të drejtë ankesë në PZAP, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i pranimit të vendimit të KQZ.
6. Votuesi i regjistruar për votim jashtë Kosovës, i cili kërkon të kthehet në listën votuese brenda Kosovës, ka kohë të bëjë kërkesën deri në 24 (njëzet e katër) orë para përfundimit të periudhës së kundërshtimit.

#### **Neni 8**

##### **Hapja e kutive postare jashtë Kosovës**

KQZ, me ndihmën e përfaqësive diplomatike, hap kuti postare jashtë Kosovës në postat e shteteve ku ka shtetas të Republikës së Kosovës. Kutitë postare jashtë Kosovës shërbejnë për të dërguar fletëvotimet shtetasit që regjistrohen suksesshëm për votim jashtë Kosovës.

#### **Neni 9**

##### **Votimi përmes postës**

1. Personi i cili është regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës dhe i cili ka zgjedhur për të votuar përmes postës, pajiset me fletëvotim:
  - 1.1. Përmes email-it, në adresën elektronike, të cilën e ka dhënë gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim, ose;

- 1.2. duke e shkarkuar fletëvotimin nga ueb faqja e KQZ-së.
2. Periudha e votimit përmes postës fillon pas miratimit të fletëvotimeve.
3. Dërgesa postare duhet të jetë individuale.

### **Neni 10**

#### **Tërheqja e dërgesave nga kutitë postare jashtë Kosovës**

1. Pakoja me fletëvotimet e dërguara në kutinë postare jashtë Kosovës tërhiqet nga ekipet e autorizuara nga KQZ, të cilët tërheqin vetëm ato pako që kanë arritur në kutinë postare deri në orën e mbylljes së vendvotimeve në përfaqësinë diplomatike.
2. Ekipi përbëhet nga së paku 2 (dy) zyrtarë të autorizuar nga KQZ.
3. Gjatë periudhës së votimit përmes postës, pakot me fletëvotime që janë dërguar në kutinë postare jashtë Kosovës tërhiqen periodikisht sipas vlerësimit të Shërbimit Votues dhe dërgohen në Kosovë si dërgesë diplomatike.
4. Pas tërheqjes së pakove me fletëvotime, të njëjtat numërohen në postë dhe vendosen në thes, i cili mbyllet me shirit të sigurisë. Ekipi i autorizuar numrin e zarfeve dhe numrin e shiritit të sigurisë duhet t'i regjistrojë në Shtojcën III – Formulari i raportimit të pakove me fletëvotimet të pranuar përmes postës në kutinë postare jashtë Kosovës.
5. Ekipi përgjegjës obligohet që formularin e plotësuar sipas Shtojcës III, ta dërgojë menjëherë përmes email adresës tek zyrtari përgjegjës i Shërbimit Votues.
6. Thesi i mbyllur dërgohet në objektin e përfaqësisë diplomatike dhe vendoset në një hapësirë të mbyllur, e cila është e vëzhguar nga kamerat e sigurisë. Materialet do të qëndrojnë në këto hapësira deri në momentin e dorëzimit tek operatori.
7. Sipas vlerësimeve të Shërbimit Votues në koordinim me ekipin e autorizuar, thasët e mbledhur në përfaqësi diplomatike të cilat janë të lidhura me shirit të sigurisë, vendosen të gjitha në një pako. Pas paketimit vendosen shiritat diplomatik dhe pako i dorëzohet operatorit.
8. Ekipi i autorizuar, pas dorëzimit të pakos te operatori, është i obliguar të përcjell te zyrtari përgjegjës i Shërbimit Votues, përmes email adresës, letër konfirmimin e dërgesës së bashku me informacionin e përcjelljes së dërgesës.
9. Pakot me fletëvotime që janë pranuar deri ditën e shtunë, në ditën kur votohet në përfaqësinë diplomatike, dërgohen si postë diplomatike, më së voni, një (1) ditë pas ditës së zgjedhjeve në Kosovë.

10. Pako me fletëvotime e cila arrin në kutitë postare të përfaqësive diplomatike pas afateve të përcaktuara, konsiderohen të pavlefshme. KQZ me procedurë të veçantë rregullon procedimin e tyre.
11. Shërbimi Votues njofton organizatat vëzhguese të interesuar për përcjelljen e procesit.

### **Neni 11**

#### **Pranimi i dërgesave me fletëvotime në Kosovë**

1. Pako me fletëvotime e dërguar në kutinë postare në Kosovë, pranohet nga KQZ deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16:00, me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve.
2. Transportimi i dërgesave postare që kanë arritur në kutinë postare në Kosovë, bëhet nën përcjelljen e Policisë së Kosovës dhe njoftohen organizatat vëzhguese.
3. Dërgesat postare që kanë arritur përmes shërbimeve postare në Kosovë, duhet të evidentohen në raport dhe të ruhen në QNR, nën mbikëqyrjen e kamerave dhe Policisë së Kosovës.
4. Për zbatim të këtij neni, KQZ lidh marrëveshje bashkëpunimi me Postën e Kosovës.
5. Dërgesa postare që vijnë si dërgesa diplomatike dhe dërgesat nga shërbimet postare private pranohen në QNR, nga zyrtarët e Shërbimit Votues.

### **Neni 12**

#### **Përbërja dhe menaxhimi i vendvotimit në përfaqësi diplomatike**

1. Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në përfaqësi diplomatike përbëhen nga 3 (tre) deri në 5 (pesë) anëtarë.
2. Përbërja e anëtarëve të KVV rregullohet sipas nenit 74 paragrafi 11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.
3. KQZ emëron menaxherë të Qendrës së Votimit në përfaqësinë diplomatike përkatëse në pajtim me dispozitivin e nenit 14 të kësaj Rregullore.
4. Menjëherë pas miratimit të vendvotimeve në përfaqësi diplomatike, Departamenti i Operacioneve Zgjedhore fton subjektet politike për të dhënë nominimet e tyre për anëtarë të KVV nga radhët e komunitetit.
5. Subjektet politike obligohen që të dërgojnë nominimet e tyre për anëtarë të KVV, jo më vonë se 15 ditë para ditës së votimit.

6. KQZ jo me vonë se njëzet e katër (24) orë pas certifikimit të subjekteve politike, miraton formulën e përbërjes dhe të ndarjes së vendeve në KVV. Pas miratimit të formulës nga KQZ, SKQZ menjëherë fton të gjitha subjektet politike të certifikuara, të dorëzojnë nominimet për anëtarë të KVV për përfaqësitë diplomatike përkatëse.
7. Emërimi i anëtarëve të KVV në përfaqësi diplomatike nga KQZ, bëhet jo më vonë se pesë (5) ditë pas pranimit të nominimeve, dhe për këtë, në të njëjtën ditë KQZ e njofton MPJD-në për emrat e anëtarëve.
8. KQZ është përgjegjëse për plotësimin e vendeve në KVV në rast se subjektet politike nuk nominojnë anëtarë të KVV.

### **Neni 13**

#### **Dërgimi i materialit zgjedhor në përfaqësi diplomatike**

1. Jo më vonë se tre (3) ditë para nisjes së pakos diplomatike që përmban materialet zgjedhore, të ndjeshme dhe jo të ndjeshme, KQZ e njofton MPJD përmes një shkrese zyrtare në të cilën specifikohen të dhënat, si në vijim:
  - 1.1. Adresa e përfaqësisë diplomatike ku planifikohet që pako të dërgohet;
  - 1.2. të dhënat dhe specifikat e materialit që përmban pako diplomatike;
  - 1.3. të dhënat e zyrtarit që caktohet për ta sjellë pakon në MPJD për validim diplomatik, të dhënat si emri dhe mbiemri, pozita zyrtare dhe numri personal;
  - 1.4. të dhënat e zyrtarit ose/apo zyrtarëve që caktohen për ta pranuar pakon në përfaqësinë diplomatike, të dhënat si emri dhe mbiemri, pozita zyrtare dhe numri personal;
  - 1.5. mënyra e transportit: ajror ose tokësor.
  - 1.6. ditën dhe kohën kur planifikohet që pako të dërgohet.
2. MPJD sipas shkresës zyrtare, në pajtim me dispozitivin e paragrafit 1 të po këtij neni, përpilon Notën Verbale për pakon specifike dhe njofton KQZ për kohën e sjelljes së pakos në MPJD për validim diplomatik, që përfshinë vendosjen e shiritave diplomatik dhe vulës së MPJD, proces ky që duhet të ndodh ditën e dërgesës.
3. Në lidhje me dërgesat diplomatike në periudhën e zgjedhjeve, MPJD është institucioni i vetëm zyrtar për procesin e validimit të pakove, që përfshinë vendosjen e shiritit diplomatik dhe vulosjes me vulë diplomatike.
4. Në ditën e dërgesës, pas njoftimit të pranuar në formë elektronike nga MPJD, KQZ obligohet që pakon ta sjellë në objektin e MPJD për vulosje dhe vendosje të shiritit. Sjelljen e pakos në MPJD duhet ta bëjë zyrtari përgjegjës sipas të dhënave në nën-paragrafin 1.3. të këtij neni.
5. Zyrtari përgjegjës në MPJD e bënë validimin e pakos dhe e njëjta largohet nga objekti i MPJD nga zyrtari përgjegjës i KQZ, i cili e dorëzon tek operatori ekonomik i kontraktuar.

6. MPJD është përgjegjëse vetëm për validimin dhe përpilimin e Notës Verbale për pakon me materialet zgjedhore të natyrës diplomatike. Në këtë proces, KQZ mbanë përgjegjësinë për pranimin, mbajtjen e dërgesës apo përcjelljen e saj tek operatori ekonomik i kontraktuar.
7. Të dhënat e përfshira në Notën Verbale nga ana e MPJD përpilohen sipas specifikave teknike të përcaktuara në shkresën zyrtare të pranuar nga KQZ. MPJD nuk merr përsipër kontrollimin e pakos para dërgesës ose verifikimin e saj, sepse kjo përgjegjësi bie mbi KQZ si parashtruese e kërkesës.
8. Procedura e përcaktuar sipas dispozitave të paragrafëve 1 deri 7 të këtij neni, zhvillohet për të gjitha paketat që planifikohen të dërgohen në përfaqësitë diplomatike nga ana e KQZ dhe anasjelltas.
9. Transporti i dërgesës nga KQZ deri në MPJD dhe largimi i saj nga objekti i MPJD bëhet nën përcjelljen e Policisë së Kosovës dhe për këtë njoftohen organizatat vëzhguese.
10. KQZ sigurohet që materiali zgjedhor të arrijë në përfaqësi diplomatike, jo më vonë se 1 ditë para ditës së votimit në përfaqësi diplomatike.
11. Materiali zgjedhor përfshin:
  - 11.1. Kutinë e votimit;
  - 11.2. fletëvotimet;
  - 11.3. distinktivët për kryesuesin dhe anëtarët e KVV;
  - 11.4. vulën për vulosjen e fletëvotimit, e cila duhet të përmbajë shënimin: logon e KQZ, llojin dhe datën e zgjedhjeve dhe numrin e vendvotimit.
  - 11.5. lidhëset e sigurisë që përmbajnë numrat serik;
  - 11.6. formulari elektronik i raportimit të daljes së votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve dhe pas mbylljes së vendvotimit;
  - 11.7. librin e votimit;
  - 11.8. formularin e përputhjes së të dhënave.

#### **Neni 14**

#### **Siguria e materialit zgjedhor**

1. Zyrtari i MPJD, i nominuar nga MPJD dhe i caktuar nga KQZ për menaxhimin e QV në përfaqësi diplomatik, është përgjegjës për:
  - 1.1. Pranimin e pakos diplomatike me materialin zgjedhor në përfaqësinë diplomatike;
  - 1.2. ruajtjen e pakos diplomatike brenda përfaqësisë diplomatike, duke u siguruar që e njëjta nuk hapet deri në ditën e votimit;
  - 1.3. mbarëvajtjen dhe menaxhimin e Qendrës së Votimit në ditën e votimit;
  - 1.4. paketimin dhe dorëzimin e materialit zgjedhor si pako diplomatike tek operatori ekonomik, së bashku me kryesuesin e KVV.



2. Zyrtari i MPJD që caktohet sipas paragrafit 1 të këtij neni për menaxhimin e QV në përfaqësinë diplomatike, do të ushtrojë funksionin e tij brenda kompetencave që janë përcaktuar për menaxherin e QV sipas Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Rregullores për themelimin e Qendrave të Votimit.
3. Zyrtari i MPJD, i cili caktohet sipas paragrafit 1 të këtij neni për menaxhimin e QV në përfaqësinë diplomatike, do të kompensohet sipas tarifës së përcaktuar nga KQZ.
4. Materiali zgjedhor, në momentin kur dërgohet në objektin e përfaqësisë diplomatike, vendoset në një hapësirë të mbyllur e cila është e vëzhguar nga kamerat e sigurisë. Pas procesit të votimit, materiali zgjedhor kthehet në hapësirën e njëjtë të vëzhguar nga kamera e sigurisë, e cila mbyllet deri në momentin e dorëzimit tek operatori.

### **Neni 15**

#### **Votimi në përfaqësi diplomatike**

1. Votimi në përfaqësi diplomatike organizohet një ditë para ditës së zgjedhjeve në Kosovë. Votimi fillon në ora 07:00 dhe mbyllet në ora 19:00, sipas orës lokale të vendit përkatës. Të drejtë votimi në përfaqësi diplomatike kanë vetëm personat që janë regjistruar suksesshëm për votim në përfaqësi diplomatike.
2. Procedurat e votimit në vendvotim në përfaqësi diplomatike, janë të njëjta me procedurën e votimit në vendvotim brenda Kosovës, e përcaktuar me Rregulloren Nr. 12/ 2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit.
3. Me rastin e votimit në vendvotimin në përfaqësi diplomatike, votuesi identifikohet përmes dokumentit identifikues të lëshuar nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi.
4. Raportimi i daljes së votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve, bëhet sipas procedurës së raportimit brenda vendit.
5. KVV pas përfundimit të votimit, ndërmerret këto veprime:
  - 5.1. Mbyll vrimën e kutisë së votimit dhe evidenton numrat e shiritave të sigurisë së kutisë së votimit në formularin përkatës për vendvotime jashtë Kosovës.
  - 5.2. evidenton numrin e nënshkrimeve të votuesve të nënshkruar në listën votuese dhe numrin e fletëvotimeve të papërdorura në formularin përkatës për vendvotime jashtë Kosovës.
  - 5.3. vendos listën votuese, vulën, fletëvotimet e papërdorura, librin e votimit, formularët dhe materialet e tjera të ndjeshme në thes, i cili lidhet me lidhësen e sigurisë dhe e cila evidentohet në formular para mbylljes së thesit.
6. Procesi i paketimit kryhet nga KVV, në prani të vëzhguesve të pranishëm.

7. Me përfundimin e procesit zgjedhor, kutia e votimit së bashku me thesin që përmban materialin e ndjeshëm zgjedhor, vendoset brenda hapësirës së dedikuar për ruajtjen e materialit zgjedhor sipas specifikave të përcaktuara në nenin 14, në të cilën qëndrojnë deri në momentin kur bëhet tërheqja nga operatori ekonomik.
8. Menaxheri i QV dhe së paku 2 anëtarë të KVV bëjnë dorëzimin e materialit zgjedhor tek operatori ekonomik i kontraktuar, i cili sipas kontratës paraqitet në përfaqësinë diplomatike përkatëse për të pranuar pakon me materialet zgjedhore.
9. Ekipet që angazhohen për organizimin e votimit në përfaqësi diplomatike, alokohen në listën votuese të përfaqësisë diplomatike, për të mos e humbur të drejtën e votimit.

#### **Neni 16**

#### **Pranimi dhe evidentimi i kutisë së votimit dhe thesit në QNR**

Procedura e pranimit dhe evidentimit të materialit nga vendvotimet në përfaqësi diplomatike rregullohet sipas Rregullores Nr.14 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

#### **Neni 17**

#### **Numërimi i fletëvotimeve**

Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.

#### **Neni 18**

#### **Votimi përmes postës në Zgjedhjet Lokale**

1. Në Zgjedhjet Lokale, votimi jashtë Kosovës nuk zhvillohet në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës.
2. Votuesit e regjistruar suksesshëm për votim jashtë Kosovës, të drejtën e votimit e realizojnë përmes postës, duke e dërguar pakon me fletëvotime në kutinë postare të KQZ në përfaqësi diplomatike ose në kutinë postare në Kosovë.

#### **Neni 19**

#### **Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar**

Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave, të drejtë vote jashtë Kosovës do të kenë vetëm votuesit, të cilët suksesshëm janë regjistruar si votues jashtë Kosovës gjatë periudhës së aplikimit, në raundin e parë.

#### **Neni 20**

#### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Nr. 06/ 2023 Regjistrimi dhe Votimi jashtë Kosovës.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore janë:  
  
**Shtojca I** – Formulari i aplikimit për regjistrim;  
**Shtojca II** – Formulari i evidentimit të dërgesave përmes postës në kutinë postare të KQZ;  
**Shtojca III** – Formulari i raportimit të pakove me fletëvotimet të pranuar përmes postës në kutinë postare jashtë Kosovës.
3. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, KQZ nxjerr procedurat dhe manualët për regjistrimin dhe votimin jashtë Kosovës.
4. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, KQZ dizajnon dhe miraton shtojcat e renditura në paragrafin 2 të këtij neni.
5. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, KQZ sigurohet që platforma elektronike për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës është zhvilluar dhe është funksionale.
6. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, KQZ lidh marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

**Neni 21**  
**Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

**Kryesues**  
**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

\_\_\_\_\_  
**Kreshnik Radoniqi**